



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	
NR/BR.	
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim - Vendim për dhënie të pëlqimit NPL "Ambienti" SH.A për dhënie në shfrytëzim të njësive Kadastrale 2025-0, 1038-0 dhe 1039-2 Z.K. Ferizaj

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 17 pika 7 Ligji Nr. 08/L-125 për Pronën Publike dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës përmes Komitetit për Politikë dhe Financa i propozon Kuvendit të Komunës të marrë:

VENDIM

Për dhënien e pëlqimit për dhënie në shfrytëzim të njësive Kadastrale 2025-0, 1038-0 dhe 1039-2 Z.K. Ferizaj

1. I ipet pëlqimi kompanisë publike NPL "Ambienti" SH.A për dhënien në shfrytëzim të njësive kadastrale 2025-0, 1038-0 dhe 1039-2 Z.K. Ferizaj.
2. Njësitë Kadastrale mund të ipen në shfrytëzim sipas Ligji Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullore (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
3. Afati për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nuk mund të jetë më shumë se 10 vite ndërsa afatgjatë maksimumi për dhënie në shfrytëzim do të jetë 40 vite, afati brenda kësaj periudhe përcaktohet me vendim të Bordit të Drejtorëve të NPL "Ambienti" SH.A, sipërfaqja e njësive Kadastrale për dhënie në shfrytëzim afatgjatë është përcaktuar në SKICËN GJEODEZIKE të lëshuar nga sektori i pronës Komuna e Ferizaj.

4. Çmimi fillestar për dhënien në shfrytëzim afatshkurtë për 1m² është 10.00 Euro, ndërsa afatgjatë qiraja përcaktohet nga Bordit i Drejtorëve të NPL “Ambienti” SH.A, në bazë të projektit apo studimit të fizibilitetit, po në asnjë rrethanë prona nuk mund të ipet në shfrytëzim afatgjatë pa qira.
5. Procedura e dhënies me qira afatshkurtër do të jetë përmes ankandit publik dhe fitues shpallet ofertuesi me çmimin më të lartë, dhe afatgjatë përmes shprehjes së interesit sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin për dhënie në shfrytëzim dhe kembim të pronës së paluejtshme që kanë të bëjnë me dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale.
6. Obligohet menaxhmenti i kompanisë publike NPL “Ambienti” SH.A që ti paraqes raport të veçantë çdo 6 muaj Kuvendit të Komunës – Kryetarit të Komunës për mënyrën e shfrytëzimit të pronës komunale ashtu siç e parasheh ligji Ligji Nr. 06/L-092 dhe Rregullorja (Qrk) Nr. 09/2020.

Të bahskangjitura i gjeni;

1. Kërkesën e NPL “Ambienti” SH.A me nr. 463-341 të datës 22.11.2024,
2. Çertifikatën e pronësisë,
3. Skicëne njërive Kadastrale.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72217092-01039-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

28.04.2025 - 09:31

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ

Komuna / Opština / Municipality:

Ferizaj / Uroševac / Ferizaj

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ

Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

Certificate draft

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72217092-01039-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /	Urban	13243	127/2009 Coptimi eshte bere ne baze te kerkeses 03-463-3 Dt.19.02.2009 dhe Aktvendimi i KK Ferizaj Dt.09.03.2009		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
LIVADHET E GJATA				



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72217092-02025-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

Komuna / Opština / Municipality:

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

Certificate draft

28.04.2025 - 09:30

FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ

Ferizaj / Uroševac / Ferizaj

FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72217092-02025-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	566	96/2010 Konkluizioni 3 Nr.463-9 Dt.04.03.2010 Sektor i Pronesis KK Ferizaj		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
"AHMET KACIKU"				



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72217092-01038-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

Komuna / Opština / Municipality:

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

Certificate draft

28.04.2025 - 09:31

FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ

Ferizaj / Uroševac / Ferizaj

FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72217092-01038-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		8846			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
LIVADHET E GJATA				





Datë:	20.11.2024
Nr.	550/24
Për:	Kryetarin e Komunës së Ferizajt z.Agim Aliu
cc:	Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi Drejtore z.Sabri Murseli
Nga :	N.P.L "Ambienti" Sh.A – Ferizaj, Kryeshef Ekzekutiv z.Arton Gavazi
Lënda :	K Ë R K E S Ë

I nderuar Kryetar Agim Aliu!

Uroj të jeni mirë dhe punët të ju ecin mbarë,

Siç edhe jeni në dijeni, në Ndërmarrjen Publike Lokale "Ambienti" Sh.A Ferizaj, Komuna e Ferizajt është aksionare e vetme në NPL "Ambienti", me 100% të aksioneve.

Me vendime të Kuvendit të Komunës së Ferizajt, Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A Ferizaj, i'u janë dhënë disa parcela në shfrytëzim afatgjatë. Në mënyrë që këto vendime të realizohen dhe të zbatohen mirë, kërkojmë nga ju të iniconi, propozoni kërkesën tonë në Kuvendin e Komunës së Ferizajt, që të na jepet pëlqimi, që për rastet që vlerësohet nga Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A Ferizaj, që parcelat që i kemi në shfrytëzim afatgjatë nga Kuvendi i Komunës, të kemi të drejtën e dhënjes me qera afatshkurtë dhe afatgjatë për personat e tretë. Parecelat që bëhet fjalë janë: Ngastra kadastrale 2025-0 Zona Kadastrale Ferizaj, me sipërfaqe 566m², vendi i quajtur "Ahmet Kaçiku", i dhënë në shfrytëzim NPL "Ambientit" në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.93 të datës 04.06.2018. Ngastra Kadastrale P-72217092-01038-0 dhe P-72217092-01039-2 Zona Kadastrale Ferizaj, me sipërfaqe prej 22089m², vendi i quajtur livadhet e gjata, i dhënë në shfrytëzim NPL "Ambientit" në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.102 i datës 12.05.2017.

Në kuadër të frymës bashkëpunuese mes Komunës së Ferizajt dhe N.P.L "Ambienti" Sh.A Ferizaj, besojmë shumë që kërkesa jonë të ketë mirëkuptimin dhe aprovimin tuaj.

Me respekt!

Kryeshef Ekzekutiv

Arton GAVAZI

KUVENDI I KOMUNËS FERIZAJ
SKUPŠTINA OPŠTINE FERIZAJ
MUNICIPAL ASSEMBLY FERIZAJ

Drejtoria për Urbanizëm, Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër

Pranuar më:	22. 11. 2024		
Njësia org	Numbri	Shtojcë	Vlerë

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalesë / Izlaze: Date / Dana 04.06.2018.		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot Br. Prot. 93	Nr. Faltëve Br. Strana 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI KOMUNAL
 SKUPSTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.93
 Data : 04.06.2018

Në mbështetje të nenit 5 pika (b) dhe (c), neni 12, neni 14, neni 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 si dhe nenit 10 Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 të datës 28.06.2013, Kuvendit i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën 31.05.2018 miratoi:

VENDIM PËR DESTINIMIN E NGASTRËS KADASTRALE 2025-0 Z.K. FERIZAJ

I

DESTINOHET: Një pjesë e ngastrës kadastrave 2025-0 Zona Kadastrale- Ferizaj me sipërfaqe prej 566 m² vendi i quajtur "Ahmet Kaqiku" Pasuri e Komunës së Ferizajt. Kjo sipërfaqe destinohet për ndërmarrja publike NPL "Ambienti" SH.A.

II

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Ferizajt e destinon ngastrën kadastrale 2025-0, Zona Kadastrale- Ferizaj me sipërfaqe prej 566 m² vendi i quajtur "Ahmet Kaqiku" Pasuri e Komunës së Ferizajt. Kjo sipërfaqe destinohet për ndërmarrja publike NPL "Ambienti" SH.A.

III

Kjo ngastrë kadastrale do të menaxhohet nga ndërmarrja publike N.P.L "Ambienti" SH.A. Kjo pronë si e tillë është pasuri e Kuvendit të Komunës dhe pas krijimit të kësaj ndërmarrje publike i drejtohem Kuvendit të Komunës që e njëjta të destinohet me qëllim të menaxhimit më të lehtësuar dhe më efikas.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë
përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e komunës.

Kryesuesja e KK-së

Kristina Gashi Bytyçi





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt Kristina Gashi Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Ferizajt
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme
Nga:	Shkelqim Jakupi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL Data: 11/06/2018 Nr.020-654
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së akteve të komunës së Ferizajt
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
E nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazikë dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktet komunale në vijim:

1. Vendimi 01Nr.91, për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesës së ngastres kadastrale nr.1166-1 z.k. Greme;
2. Vendimi 01.Nr.93 për destinimin e ngastrës kadastrale 2025-0;
Të miratuar më datë: 31/05/2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04/06/2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të komunës si më sipër, vlerëson se aktet e komunës në aspektin procedural **janë në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si të tilla mund të prodhojnë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izdane / Issued: 26.05.2017		
Nr. Org. / Org. No. / No. Org.: 01	Nr. Prot. / Br. Prot. / Br. Prot.: 102	Nr. Fiqeve. / Br. Strana. / Br. Strana.: 1

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj/>



KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 102

Datë: 12.05.2017

Në mbështetje të nenit 5, 12, 17 pika (1), si dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/ L-040 si dhe nenit 10,25 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt, në mbledhjen e mbajtur me 12.05.2017, miratoi këtë:

V E N D I M

I

DESTINOHEN : Ngastrat P-72217092-01038-0 dhe P-72217092-01039-2, Zona Kadastrale-Ferizaj me sipërfaqe të tërësishme prej 22089 m², vendi i quajtur “Livadhet e Gjata”, Pasuri e Komunës së Ferizajt.

II

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Ferizajt i destinon ngastrat P-72217092-01038-0 dhe P-72217092-01039-2, Zona Kadastrale - Ferizaj me sipërfaqe të tërësishme prej 22089 m², vendi i quajtur “Livadhet e Gjata”, Pasuri e Komunës së Ferizajt, që t'i merr nën menaxhim ndërmarrja publike N.P.L “Ambienti” SH.A.

III

Këto ngastra kadastrale do të menaxhohen nga ndërmarrja publike N.P.L “Ambienti” SH.A. Kjo pronë si e tillë është pasuri e Kuvendit të Komunës dhe kjo pronë komunale destinohet për këtë ndërmarrje publike për menaxhim më të lehtësuar të tregut të gjelbërt.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Faruk Guri